



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.04.2025

Numër Protokolli: 2757/2025

A.nr.151/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.151/2025, të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesit A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.T, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.XH, G.N, M.M, Sh.Adhe S.LL, të cilët sipas autorizimit të përbashkët i përfaqëson ankuesja G.K, kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.151/2025, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga ankuesit, A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.TH, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.XH, G.N, M.M, Sh.A dhe S.LL ashtu që **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, rastin e ankuesve t’a dërgoj për shqyrtim tek Komisioni për Kushte të Tregut të Punës.

II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken I të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësit Civil, A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.TH, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.XH, G.N, M.M, Sh.A dhe S.LL(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), me datë 21.01.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 397/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 05-160 të datës 13.01.2025, të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 13.02.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimi të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1486/2025 të datës 07.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për shqyrtimin e kësaj lënde administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 397/2025 të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesit në Këshill; Autorizimin e ankuesve; Vendimin me Nr.36/2023 të datës 30.08.202, së bashku me listën e profesionistëve shëndetësor në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë; Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 05-160 të datës 13.01.2025; Dokumentet e identifikimit dhe akt emërimit e ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 13.02.2025; Konkursin me numër reference RN00011467 të datës 24.04.2023, për 23 pozitat Inspektor Shëndetësor; Kualifikimet arsimore (diplomat) dhe licencat e punës të ankuesve; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të ankuesve.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesve, është e bazuar, dhe se ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që rastin e ankuesve t'a dërgoj për shqyrtim tek Komisioni për Kushte të Tregut të Punës, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në pozitat e punës *Inspektor Shëndetësor* pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedh se Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes Vendimit Nr.36/2023 të datës 30.08.2023, ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës, për shtesa për kushte të tregut të punës, për profesionistët shëndetësor të punësuar në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë, në shumën e shtesës prej dyqind e

pesëdhjetë (250) euro në muaj, gjegjësisht për 45 nëpunës civil të kësaj Ministrie, ku në mesin e tyre ka përfshirë edhe Inspektorët e Shëndetësor.

Ankuesit, me datë 02.08.2024 kanë parashtruar kërkesë të përbashkët tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore pranë organit përkatës të punësimit, përmes të cilës shkresë kanë kërkuar plotësimin e Vendimit Nr.36/2023 të datës 30.08.2023 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për realizimin e shtesës për kushte të tregut të punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për profesionistët shëndetësorë të punësuar në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë, mirëpo të njëjtit nuk kishin pranuar përgjigje kundrejt kërkesës së tyre, ashtu që më datë 11.11.2024 kanë parashtruar ankesë, kundër heshtjes administrative në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, meqenëse ishte konstatuar se lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 02.08.2024 institucioni nuk kishte nxjerr akt administrativ, lënda ishte kthyer në detyrim tek Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht përmes Vendimit A.nr.1708/2024 të datës 14.03.2024 ishte detyruar Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 02.08.2024 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërsa, Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 13.01.2025 ka nxjerrë përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 05-160, përmes së cilës ka theksuar se, citoj: *“Sekretari i Përgjithshëm, në fillim të vitit 2024 ka formuar një Grup përgjegjës, ad hoc, për shqyrtimin dhe analizimin e situatës lidhur me shtesat në pagë për nëpunësit civil në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Grupi përgjegjës, pas analizës së situatës, ka ardhur me një përfundim dhe ka rekomanduar se: Inspektorët Shëndetësor dhe Farmaceutik të përjashtohen nga lista e kuadrove deficitare për arsye, si në vijim: 1. Inspektorët Shëndetësor dhe Farmaceutik kanë koeficient 7.4, i barasvlershëm me koeficientin e Mjekut të Përgjithshëm në Sistemin Shëndetësor, për dallim nga Zyrtarët e lartë në Administratën Qendrore që ka koeficient 5.75; dhe 2. Për arsye se në Inspektoratin Shëndetësor dhe Farmaceutik ka profile tjera të shkollimit të cilat janë përjashtuar nga e drejta e kësaj shtese dhe mos të ketë diskriminim për pozitën/punën e njëjtë dikush të përfitoj shtesë dhe dikush jo. Lidhur me **Inspektoratet**, Grupi përgjegjës ka rekomanduar që të iniciohet kërkesë për **“shtesë për rrezikshmëri në punë”**, e cila parashihet me legjislacionin në fuqi, ku do të përfshiheshin të gjithë inspektorët pa dallim. Sipas Informacioneve që posedojmë, menaxhmenti i Ministrisë është duke e trajtuar çështjen dhe do të merret një qëndrim lidhur me procedurat e mëtejme”*

Ankuesit, e pa kënaqur me përgjigjen e lartë theksuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se me anë të kësaj përgjigjes nuk është shqyrtuar fare kërkesa e tyre për ndryshim dhe plotësim të listës së të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret, bazuar në Nenin 10 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, duke theksuar ndër të tjera që organi i punësimit nuk ka adresuar këtë informim, dhe se duke mos u përditësuar lista dhe duke mos u kompensuar shtesat në fjalë janë duke u shkelur parimet themelore të Ligjit për Paga, përkatësisht i parimi barazisë dhe mos-diskriminimit.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesve, ju referua legjislacionit të aplikueshëm për pagat në sektorin publik, gjegjësisht:

Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht Nenit 1, ku përcaktohet se: *Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.* Nenit 4, ku përcaktohet se: *1. Sistemi i pagave i rregulluar me këtë ligj bazohet në parimet e mëposhtme: 1.1. parimi i ligjshmërisë - nënkupton se e drejta në pagë përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të autorizuara dhe të nxjerra në zbatim të tij; 1.2. parimi i transparencës – nënkupton që përcaktimi i pagës dhe të drejtave të tjera që burojnë nga paga, është informacion me interes publik dhe trajtohet në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale; 1.3. parimi i parashikueshmërisë – nënkupton se niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, mund të ulet, vetëm në bazë të ligjit; 1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit – nënkupton që secili, pa kurrëfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin.* Nenit 13, ku përcaktohet se: *Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji.* Nenit 22 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale. si dhe Nenit 24, paragrafi 1 dhe 4 ku përcaktohet se: 1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për profesione të nevojshme, në pozita të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunëseve/ve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur. 4. Profesione të përcaktuara për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut të punës për nëpunësen/in civile dhe nëpunësen/in e/i shërbimit publik, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për financa. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut të punës për nëpunës të shërbimit civil rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet.*

Rregullores (MFPT) Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, përkatësisht Nenit 1, ku përcaktohet se: *Kjo Rregullore përcakton profesionet, kushtet dhe procedurat për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës. Nenit 2, i cili përcakton se: “Kjo Rregullore zbatohet për të punësuarit në sektorin publik, pagat e të cilëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit dhe të cilët i plotësojnë kriteret për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje” si Nenit 4, i cili përcakton se : ” 1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për pozita të caktuara deficitare dhe të rralla të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur ose ka vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin 2. Shtesa për kushte të tregut të punës mund të përfitohet kur plotësohen kumulativisht kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, kur kriteret e veçanta aplikohen për secilin profesion deficitar. 3. Kriteret e përgjithshme, janë si në vijim: 3.1. nëpunësi civil apo nëpunësi i shërbimit publik është i punësuar në pozita specifike profesionale, drejtuese, si dhe specialistët; 3.2. rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto pozita specifike për shkak të kualifikimeve të mbajtësit të pozitës krijon vështirësi për shkak se tregu privat ofron paga dukshëm më të larta se sektori publik; 3.3. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve krijon probleme në funksionimin e rregullt të njësive administrative. 4. Profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë: 4.1.profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative; 4.2. profesionet deficitare në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror; 4.3.profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës; 4.4.specialistët shëndetësor në profesione deficitare, ashtu siç përcaktohen nga ministria përkatëse për shëndetësi; si dhe 4.5.pozita tjera të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve me pagat e rregullta në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur. si dhe paragrafit 1, 2 dhe 3 të Nenit 10, ku përcaktohet se: 1. Për përfitimin e shtesës sipas kësaj Rregulloreje, Ministria përgjegjëse për Financa themelon Komision me mandat tre (3) vjeçar, në përbërje si në vijim: 1.1. Dy (2) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa; dhe 1.2. Një (1) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për administratë publike. 2. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore e secilit institucion përgatitë listën e të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret e kësaj Rregullore dhe e përcjellë atë tek Komisioni sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. 3. Lista e të punësuarave, sipas paragrafit 2 të kësaj Rregulloreje, duhet të përmbajë të dhënat si në vijim: 3.1.emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil; 3.2.pozitën e nëpunësit civil; 3.3.përshkrimin e detyrave të punës; dhe 3.4.propozimin e arsyetuar për nivelin e shtesës.*

Rrjedhimisht, Kolegjit i Këshillit nga analizimi i përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 05-160 të datës 13.01.2025, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve për mos zbatim të dispozitave të Rregullores Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës janë të bazuara, ngase sipas këtyre përcaktimeve ligjore Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e organit përkatës të punësimit është dashur të dërgoj listën e ankuesve tek Komisioni për Kushte të Tregut të Punës, ndërsa në rastin konkret janë dhënë vetëm rekomandime, duke mos u zbatuar kështu dispozitat ligjore për procedurën e përfitimit të shtesës për kushtet e tregut të punës, të përcaktuar nga neni 10 i kësaj rregulloreje.

Andaj, bazuar në konstatimin si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesve, me detyrimin ligjor që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, duke respektuar parimet e sistemit të pagave brenda institucionit përkatës, të veprojnë në pajtim me nenin 10 paragrafin 2 dhe 3 të Rregullores Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ashtu që rastin e ankuesve t'a dërgoj për shqyrtim tek Komisioni për Kushte të Tregut të Punës.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.151/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses të autorizuar të ankuesve, ankueses G.K;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.